



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 651/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt: “*Sherbimi i mirembatjes se pajisjes ‘Skaner Toshiba / TSX-021B/4’ per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Kukes per periudhen Korrik –Dhjetor 2017*”, fond limit 1.601.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtori e Shërbimit Spitalor Kukës.

Ankimues:

“BNT Electronics” sh.p.k.
Bulevardi “Zhan D’ark”, Kulla III, Kati II, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës
Lagjja 7, qyteti Kukës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.06.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me objekt: “*Sherbimi i mirembatjes se pajisjes ‘Skaner Toshiba / TSX-021B/4’ për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukës për periudhën Korrik –Dhjetor 2017*”, fond limit 1.601.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtori e Shërbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datën 02.08.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “BNT Electronics” sh.p.k.

1.600.000 lekë,skualifikuar

II.3. Në datën 02.08.2017 operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Skualifikohet ;Se në vërtetimin e Drejtorisë së Shërbimit të Tatim Paguesve me Nr,prot 10438, dt.15.05.2017, rezulton të jetë me detyrim prej një shume 58.120.000 lek.gjoba si dhe 500.000 lek Gjoba në kontribute të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore. Tek kriteret e Përgjithshme pika, 2 germa (b

II.4. Në datën 07.08.2017 operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor .

Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]

Operatori ynë ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. si pjesmarrës në tenderin e sipërpërcaktuar rezulton të jetë skualifikuar për arsye sepse sipas ak-së figurojmë me detyrim tatimor (gjorbë në vlerën 58.120.000 lekë si dhe 500.000 lekë gjorbë në sigurimet shoqërore)të cilat janë në proces ankimimi.

Vendimi i mbajtur nga ak-ja nuk është i drejtë dhe është në kundërshtim me ligjin për këtë arsye referojmë nenin 63 të LPP-së[...].

Konstatojmë se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk përbën kusht skualifikues. Në kriteret e përgjithshme për kualifikim është kërkuar të paraqitet një dokument që vërteton se oe ka plotësuar detyrimet fiskale ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Shoqëria “BNT Electronics” sh.p.k në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur në tender vërtetimin nr. 10438 datë 15.05.2017 ku shprehet se : “BNT Electronics” për periudhën deri më datë 15.05.2017nuk ka detyrim tatimor në tatimin mbi vlerën e shtuar, tatim i mbajtur në burim, tatim mbi të ardhurat personale. Subjekti ka detyrime (gjoba) 58.120.000 lekë në glbal dhe 500.000 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore të cilat janë në procedurë ankimimi administrativë.

Pra sic shihet nga ky vërtetim rezulton se “BNT Electronics” sh.p.k ka paguar të gjitha detyrimet tatimore arsye se “BNT Electronics” i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara si nga ana ligjore edhe nga ajo teknike përfshirë këtu edhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatim paguesëve të Mëdhenj. Ky vërtetim e përcakton qartë se “BNT Electronics” nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar me përjashtim të gjobave të cilat janë në proces ankimimi.Referojmë vendimin unifikues nr. 4 datë 19.05.2011 të Gjykatës së Lartë, po ashtu udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008 të Ministrisë të Financave [...]si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH (ndryshuar me ligjin nr. 179/2013 datë 28.12.2013) neni 107 [...]

Pra sic e shohim edhe nga faktet ligjore të mësipërme gjobat nuk përfshihen tek ato detyrime tatimore që duhet të shlyhen më parë se të ankohen, por gjobat për sa kohë janë n proces ankimimi nuk konsiderohen si detyrim tatimor që duhet të parapaguhet. Theksojmë se gjobat megjithëse konsiderohen pjesë e detyrimit tatimor nuk përfshihen si pjesë e parapagimit të detyrimit si kusht i domosdoshëm për

të marrë në shqyrtim ankimin administrativ. Ky qëndrim është mbajtur edhe në një vendim të KPP-së nr. 244/2015[...]

Ky skualifikim i padrejtë që na është bërë nuk përkon as me frymën e legjislacionit për prokurimin publik sepse llogjikisht dhe ligjërisht gjopa do të opaguhet në një moment të dytë nëse ankimi i oe-së rezulton i pasuksesshëm, por nga ana tjetër dëmi që mund tu vijë financave publike nga skualifikimi i një operatori që potencialisht mund të ketë ofertuar me cmimin më të ulët, por që është skualifikuar për mospagiminn në kohë të saj, është i pariparushëm, kjo e cila bie në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për përzgjedhjen e oe-së fitues në prokurimin publik, dukerespektuar dispozitat ligjore në fuqi, sikurse nuk ka ndodhur në këtë rast duke qënë se vendimi i skualifikimit është në kundërshtim me gjithë dispozitat e mësipërme si dhe me LPP-në. Përsa argumentuam më sipër, bazuar në të gjithë dispozitat ligjore të përcaktuara duke bashëngjitur edhe vendimin e KPP-së i cili ka dhënë një vendim unifikues lidhur me gjobat në proces ankimimi, kërkojmë të pranohet ankesa jonë, të kualifikohet oferta e paraqitur nga shoqëria “BNT Electronics” shpk si dhe të vazhdojmë me procedurat e mëtejshme për lidhjen e kontratës.

II.5. Autoriteti Kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda afateve të përcaktuara në LPP.

II.6. Në datën 24.08.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 05.09.2017, nëpërmjet shkresës me nr.1412/2 prot., me objekt: “Kthim përgjigje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k.

Public Health Sector

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. se “ në vërtetimin e Drejtorisë së Shërbimit të Tatim Paguesve me Nr.prot 10438, dt.15.05.2017, rezulton të jetë me detyrim prej një shume 58.120.000 lek.gjopa si dhe 500.000 lek Gjopa në kontribute të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore. Tek kriteret e Pergjithshme pika, 2 germa (b)”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 6 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2 është kërkuar: *“Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore”*;

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton se është paraqitur *“Vërtetimi nr. 10438 prot., datë 15.05.2017, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për detyrimet fiskale e sigurimet shoqërore”*;

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton se në Vërtetimin nr. 10438 prot., datë 15.05.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për detyrimet fiskale e sigurimet shoqërore, shoqëria “BNT Electronics” sh.p.k. ka detyrim (gjoba) 58.120.000 lekë në Global,dhe 500.000 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore, të cilat janë në procedurë ankimi administrativ.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*;

Komisioni i Prokurimit Publik, për të arritur në vendimarrje vlerësoi se duhej të kishte parasysh:

- jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shiko Vendimin nr.16, datë 25.07.2008) - në bazë së të cilës janë bërë dhe ndryshime në legjislacionin tatimor;
- Vendimin Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Lartë – i cili shprehet se:

“Me “detyrim tatimor”, Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Dallohet qartësia në ligj që, për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-Vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat.

Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.”

- Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” (ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013), neni 107 i të cilit parashikon se:

“1.Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shumën e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimit.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”

- Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrisë të Financave që parashikon se:

“Shuma e detyrimit për t'u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjokat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi”.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen gjoka të cilat janë në proces ankimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik.

Komisioni vlerëson të adoptojë një interpretim të ngushtë e teleologjik të togflalëshit “detyrimet për pagimin e tatimeve” të parashikuar nga neni 45, pika 2, gërma “dh” i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit të procedurave të prokurimit publik.

Në balancën mes përpjekjes për të siguruar *pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor*, nga njëra anë, dhe *mirpërdorimin e fondeve publike* – që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoka është në proces ankimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës.

Public Health Sector

Rrjedhimisht, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt: “Shërbimi i mirembatjes së pajisjes ‘Skaner Toshiba /TSX-021B/4’ për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukës për periudhën Korrik–Dhjetor 2017”, fond limit 1.601.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtori e Shërbimit Spitalor Kukës.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera, , në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave *“Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”*.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1412 Protokolli, Datë 24.08.2017

